



Njoftim për Shtyp

KORRUPSIONI NË SHQIPËRI - GJENDJA AKTUALE

Zyrtarët ushtrojnë më shumë presion për të marr ryshfet

Pothuajse një në dy shqiptarë të rritur thonë se zyrtarët publikë kanë kërkuar ryshfet prej tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë.

Kjo është një nga gjetjet kryesore që do të shpallet në konferencën e datë 12 Maj.

Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit për Shqipërinë gjurmon presionin e korrupsionit, përfshirjen e qytetarëve në korrupsion, dhe perceptimet e tyre për nivelin e korrupsionit në vend. Ai gjithashtu mat kapacitetin dhe aftësinë e autoriteteve shqiptare për të trajtuar problemin në mënyrë efektive.

Ky studim i fundit ka gjetur se *rastet e ryshfetit* janë përkeqësuar me rreth 5 përqind në krahasim me të njëjtin studim në vitin 2014.

Kjo tregon se ka pasur një rritje të pranuar të presionit të korrupsionit nga zyrtarët publikë të qytetarëve. Edhe pse është e qartë se kjo nuk është ajo çfarë publiku shqiptar dhe partnerët ndërkombëtare kanë synuar, rezultate të tjera nga Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit theksojnë gjithashtu disa zhvillime pozitive. Përveç kësaj, ato ofrojnë edhe informacion të rëndësishëm në mënyrën se si mund të trajtohet problemi në mënyrë efektive në Shqipëri.

Rezultatet e plota të Sistemit të Monitorimit të Korrupsionit për Shqipërinë, 2016, do të zbulohen në një konferencë në Tiranë, kushtuar rolit të shoqërisë civile në politikën e mirëqeverisje dhe antikorrupsionit në Shqipëri dhe në Evropën Juglindore.

Konferenca do të përfshijë pjesëmarrës nga shoqëria civile dhe sektori publik, për të diskutuar gjetjet dhe konsultuar rekomandime politike të lidhura me raportin.

Kur: 12 Maj 2016, 14:00

Ku: Salla "Teuta", Tirana International, Tirana, Albania

Kush: Më shumë se 40 figura publike dhe profesionistë të antikorrupsionit nga institucionet qeveritare, institucionet e BE-së, shoqëria civile dhe sektori privat.

Kontakt: Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER), acer@abcom.al, +355 45 352 005, +355689090015

Shënim: Teksti në këtë Njoftim për Shtyp mund të shpërndahet lirisht me kusht që titulli i aktivitetit dhe emrat e organizatorëve të jenë përmendur qartësisht.